	PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS		F-113
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Ekspert/e për ofrimin e mbështetjes në realizimin e podkastit me temë <i>“Impakti i mirëqenies psikologjike të nxënësve në rezultatet mësimore”</i> dhe hartimin e raportit analitik përkatës pas podkastit.
Kodi i procedurës së rekrutimit	IDEA
Emërtimi i projektit	Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit / Innovating Development in Education Advancement – IDEA 2022
Kodi dhe emërtimi i aktivitetit	IDEA ZB. 16 – Realizimi i podkastit për fushën e arsimit
Numri i ditëve të punës	Deri në 5 ditë pune
Periudha e angazhimit	3 tetor 2022 – 15 tetor 2022

Qëllimi i konsulencës


Qëllimi i kësaj konsulence është ofrimi i ekspertizës drejt realizimit të podkastit me temë *“Impakti i mirëqenies psikologjike të nxënësve në rezultatet mësimore”* dhe hartimi i raportit analitik mbi bazën e përmbajtjes së diskutimeve aty.

Ky podkast synon të analizojë aspektin psikologjik të nxënësve të nivelit parauniversitar në vazhden e procesit mësimor dhe në ambientin shkollor, si dhe ndikimin e tij tek rezultatet mësimore të nxënësve. Pjesëmarrësit në diskutim janë njohës të sektorit të arsimit dhe ekspertë të fushës së psikologjisë dhe aspekteve të ndërlidhura. Këto palë relevante do të diskutojnë rreth gjendjes aktuale me psikologët në shkollat e Kosovës, dhe do të shkëmbejnë perspektivat përkatëse. Analiza e diskutimit mëton të nxjerrë në pah shkaqet dhe arsyet e gjendjes aktuale, problemeve që shfaqen dhe sfidave që hasen, dhe synon të nxjerrë rekomandime lidhur me mënyra konkrete të adresimit të tyre.

Diskutimi i zhvilluar në podkast do të përmbledhet në formën e një raporti analitik, ku të theksohen pikat më të rëndësishme dhe idetë e dala për trajtimin e këtyre sfidave në fushën e arsimit në Kosovë.

Përshkrimi i projektit

Projekti një-vjeçar *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit / Innovating Development in Education Advancement – IDEA 2022* financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Ky program është pjesë përbërëse e Strategjisë së KEC 2020-2024, dhe si i tillë synon të përmirësojë cilësinë dhe llogaridhënien përmes avokimit dhe përfshirjes në politikëbërje, monitorimit të zbatimit të politikave, realizimit të hulumtimeve në fushën e arsimit, si dhe organizimit të diskutimeve publike.

	PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS		F-113
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

Qëllimi i konsulencës është ofrimi i ekspertizës drejt realizimit të podkastit dhe hartimit të një raporti analitik mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga diskutimet në podkastin me temë *“Impakti i mirëqenies psikologjike të nxënësve në rezultatet mësimore”*. Angazhimi përfshin aktivitetet në vijim:

- Zhvillimi i planit të punës për realizimin e podkastit në bashkëpunim me Menaxherin e Projektit;
- Moderimi dhe mbikëqyrja e ecurisë së podkastit dhe diskutimeve;
- Hartimi i raportit analitik mbi bazën e të dhënave nga diskutimi në podkast.

Rezultatet e pritshme

- Përmbledhje dhe analizë e përmbajtjes së diskutimeve në podkast;
- Mbledhja e të dhënave sasiore dhe cilësore, varësisht nga tema e podkastit;
- Hartimi i raportit analitik rreth debatit në podkast.

Kualifikimet

- Kualifikim i nivelit baçelor, preferohet niveli master, në fushën e shkencave sociale, të edukimit, komunikimeve e të ngjashme;
- Njohje e dëshmuar e sektorit të arsimit në Kosovë dhe e çështjeve që kanë të bëjnë me nxënësit dhe mësimdhënësit në nivelin parashkollor;
- Njohje ose përvojë me platforma të ndryshme mediatike në realizimin e editorialeve/reportazheve dhe/ose në produksion të podkasteve;
- Njohuri të metodave themelore të hulumtimit në shkencat shoqërore;
- Përvojë të mëhershme në hartimin e raporteve dhe editorialeve në fushën e arsimit;
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe angleze;
- Shkathtësi të mira të komunikimit dhe prezantimit të të gjeturave nga raportet.

Raportimi

Konsulenti/ja i raporton Menaxherit të Projektit.

Dokumenti duhet të dorëzohet në formë elektronike (në formatin Ms Word, fonti Times New Roman, madhësia e fontit 12), në gjuhën shqipe ose angleze.